



CRNVO
CENTAR ZA RAZVOJ NVO



RESURSNICENTAR
Centar za razvoj nevladinih organizacija



Institut za medije Crne Gore
Montenegro Media Institute



UDHËZUES

PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE



Ky dokument u krijua në kuadër të projektit Qendra e Resurseve për Organizatat e Shoqërisë Civile – Faza II, të cilin e realizon Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare - CRNVO, në partneritet me Institutin për Media të Malit të Zi dhe OJQ Natura, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e CRNVO dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



HYRJE

Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO) ka filluar me realizimin e projektit "**Qendra e Resurseve për Organizatat e Shoqërisë Civile - Faza II**", financuar nga **Bashkimi Evropian**, përmes **Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi**. Projekti zbatohet në partneritet me **Institutin për Media të Malit të Zi** dhe **OJQ Natura**. Konsorciumi i Qendrës së Resurseve, përveç CRNVO dhe OJQ Natura, përbëhet edhe nga partnerët tanë shumëvjeçarë dhe Qendrat e Resurseve Lokale: **OJQ Nada, Qendra Demokratike e Bijello Poles, OJQ Horizonti i Ri** dhe **OJQ Bonum**.

"Qendra e Resurseve për Organizatat e Shoqërisë Civile - Faza II" është vazhdim i projektit të mëparshëm, si dhe aktiviteteve shumëvjeçare të CRNVO-së në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile dhe krijimin e një mjedisi stimulues për veprimin e saj.

Qendra e Resurseve si një format i ri në kuadër të organizatës sonë, në dy vitet e ardhshme gjatë këtij projekti do të përfaqësojë një qendër shërbimi për mbështetjen e përditshme të të gjitha organizatave të shoqërisë civile, si dhe individëve aktivistë dhe aktiviste në kuadër të programit të fuqizimit të kapaciteteve, shërbimeve help-desk, hulumtimeve, organizimit të takimeve publike, panaireve, konferencave, dhe aktiviteteve të ngjashme. Paralelisht me ofrimin e një sërë shërbimesh, do të punojmë në ndryshimin e kuadrit ligjorë dhe ndryshime të tjera, të cilat mundësojnë punën e papenguar të OJQ-ve dhe do të kërkojmë intensivisht zbatimin e këtyre zgjidhjeve.

Qëllimi i përgjithshëm i Qendrës së Resurseve është forcimi i organizatave të shoqërisë civile dhe mediave që kontribuojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e demokracisë pjesëmarrëse në Mal të Zi. Ndërsa qëllimi specifik i Qendrës së Resurseve është të përmirësojë kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave për të qenë aktorë proaktiv, efikas, dhe të përgjegjshëm, si dhe të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi që favorizon zhvillimin e shoqërisë civile.

Në kuadër të projektit "Qendra e Resurseve për organizatat e shoqërisë civile – faza II", do të organizohen një sërë programesh për fuqizimin e kapaciteteve, një numër i madh ngjarjesh dhe takimesh publike. Organizatat e shoqërisë civile njëkohësisht kanë të drejtën të shfrytëzojnë shërbimet help-desk të CRNVO - Qendrës së Resurseve për organizatat e shoqërisë civile si dhe të shërbimet e qendrave të resurseve lokale: OJQ Natura, OJQ Nada, Qendra Demokratike e Bijello Poles, OJQ Horizonti i Ri dhe OJQ Bonum.

Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve ofron informata mbi shërbimet help-desk të Qendrës së resurseve dhe qendrave të resurseve lokale, llojin e shërbimeve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre, si dhe vlerësimin e shërbimeve dhe evidentimin e shfrytëzuesve.

Qendra e Resurseve mbetet adresa e parë për të gjitha organizatat e shoqërisë civile dhe individët të cilët planifikojnë të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë në të gjitha segmentet, si shoqatë apo organizatë.



Katalogu dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve të Qendrës së Resurseve

SHFRYTËZUESIT E QENDRËS SË RESURSEVE JANË:

- Organizatat joqeveritare
- Mediat
- Vetëqeverisjet lokale
- Organet shtetërore
- Donatorët
- Kompanitë
- Qytetarët dhe qytetarët

Qendra e Resurseve CRNVO dhe qendrat e resurseve lokale: OJQ "Natura" në Kollashin, OJQ "Qendra Demokratike e Bijello Poles" në Bijello Pole, OJQ "Bonum" në Plevla, OJQ "Horizonti i Ri" në Ulqin dhe OJQ "Nada" në Herceg Novi, shfrytëzuesve të vet iu ofrojnë këto shërbime:

1. HELP-DESK

Të gjitha shërbimet në kuadër të këtij lloji të mbështetjes (përveç pasqyrës ditore të aktiviteteve të OJQ-ve) janë në dispozicion për palët e interesuara, **në orarin 10-14h, nga e hëna në të premte.**

Ky shërbim ka të bëjë me llojet e mëposhtme të mbështetjes së OJQ-ve:

a) Mbështetje për themelimin e OJQ-ve

Individët e interesuar dhe personat juridikë që dëshirojnë të themelojnë OJQ do të marrin këshilla relevante nga juristi, formularët që nevojiten për regjistrim, informata për procedurën e hapjes së llogarisë bankare, tekstin e ligjit për OJQ dhe informacione të tjera të nevojshme dhe udhëzime specifike. Meqenëse formularët e themelimit të shoqatave dhe fondacioneve janë të gatshëm dhe nënkuptojnë plotësimin e rubrikave që ekskluzivisht varen nga vendimi i palëve të interesuara, CRNVO nuk do të përgatisë akte të plota në emër të personave të interesuar, por gjithsesi do të ofrojë të gjitha këshillat e nevojshme për mënyrën se si kjo duhet të bëhet.

b) Këshilla ligjore dhe financiare për punën e OJQ-ve

Organizatat joqeveritare të interesuara do të marrin këshilla ligjore dhe financiare për punën e përditshme. Këto çështje përfshijnë marrëdhëniet e punës, çështjet e taksave dhe tatimeve dhe çështje të tjera ligjore që zbatohen në punën e OJQ-ve.

c) Konsultimet në përgatitjen e projekteve dhe realizimin e projekteve (për konkurset lokale dhe ato shtetërore, projekte të financuara nga fondet e BE-së dhe për konkurse tek donatorët tjerë)

Ky shërbim përfshin dhënien e komenteve dhe sugjerimeve në parim për një version të plotë të propozimit të projektit. Projektet duhet të dorëzohen ekskluzivisht me e-mail. CRNVO mund të ofrojë këshilla për përputhshmërinë e përgjithshme të propozimit të projektit me thirrjen specifike, qëllimet e projektit dhe shumën e buxhetit. Afati për dorëzimin e drafteve të projekteve është jo më vonë se 7 ditë para afatit për dorëzimin e versionit përfundimtar të projektit tek donatori.

Vërejtje: Ky shërbim përjashton mundësinë e CRNVO-së dhe qendrave të resurseve lokale që të shkruajnë propozime projektesh për organizata të tjera.

d) Informata ditore në lidhje me të gjitha thirrjet publike për OJQ, ngjarjet, lajmet në lidhje me OJQ-të, nëpërmjet listës elektronike të CRNVO-së

Ky shërbim nënkupton ofrimin e informatave të rëndësishme për punën e OJQ-ve në bazë ditore. Informatat kanë të bëjnë me thirrjet publike të organeve shtetërore në lidhje me përgatitjen e politikave publike (strategji, ligjeve etj.), aktiviteteve që organizojnë organet shtetërore dhe qeverisjet vendore, informata për konkurset për ndarjen e mjeteve OJQ-ve dhe informatave tjera relevante.

Në mënyrë që përdoruesi të regjistrohet në listën e e-mailit duhet të dërgojë një e-mail bosh në: crnvo-subscribe@googlegroups.com, ose të regjistrohet nëpërmjet faqes së parë të web-sajtit. Pas kësaj, automatikisht do të marrë një e-mail në e-mailin e tij që kërkesa për regjistrim është pranuar. Më pas përgjigjuni këtij mesazhi (reply + send). Kur dikush dëshiron të dërgojë një njoftim, një pyetje, etj., për anëtarët e listës, ai e bën këtë duke dërguar një email tek crnvo@googlegroups.com.

RREGULLAT E PËRDORIMIT TË LISTËS E-MAIL-it TË CRNVO-së

- Lista e e-maileve të CRNVO-së u krijua në vitin 2001 me qëllim të shkëmbimit të informatave midis OJQ-ve si dhe informatave që kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin OJQ-të veprojnë në Malin e Zi. Lista e e-maileve duhet të mundësojë informim më të mirë për konkurset në dispozicion, debatet publike, mundësitë e pjesëmarrjes në trupat që formojnë institucionet publike, obligimet ligjore të OJQ-ve, trajnimet që ofrohen, ngjarjet e organizuara nga OJQ-të, iniciativat dhe informacione të tjera të rëndësishme për OJQ-të.
- Qëllimi specifik i krijimit të listës së email-eve të CRNVO-së është të inkurajojë dialogun midis përfituesve, shkëmbimin e mendimeve dhe qëndrimeve lidhur me çështjet që i referohen punës dhe aktiviteteve të OJQ-ve.
- Përdoruesit e listës së email-eve të CRNVO-së janë kryesisht OJQ, por edhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë të cilët janë të interesuar në marrjen dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me OJQ-të.
- Të gjithë përdoruesit e listës kanë të njëjtat të drejta në aspektin e marrjes së informatave në kohë – çdo informatë në të njëjtin moment i shkon çdo përdoruesi të listës.
- Rregullat për përdoruesit e listës janë si më poshtë:
 - Nuk lejohet nxitja për shkeljen e Kushtetutës së Malit të Zi;

- Nuk lejohet të përdoret gjuha e urrejtjes, përhapja e diskriminimit fetar, nacional, gjinor, etj.;
 - Nuk lejohet dërgimi i përmbajtjeve të papërshtatshme
 - Nuk lejohet ofendimi dhe sjellja e informatave të pakonfirmuara në lidhje me OJQ-të dhe anëtarët e tyre;
 - Nuk lejohen akuzat e ndërsjella të përdoruesve të listës, të cilët janë në konflikt tek organet gjyqësore në lidhje me një çështje të veçantë;
 - Nuk lejohet fushata e drejtuar kundër çdo OJQ-je anëtare të listës;
 - Nuk lejohet të përdoren shprehje vulgare dhe të papërshtatshme;
 - Nuk lejohet të privatizohet lista e e-mailit për të shkëmbyer informacion privat midis përdoruesve të listës.
- CRNVO ruan të drejtën për të përjashtuar nga lista përdoruesit që nuk pajtohen me këto rregulla.
- Përdoruesit që janë përjashtuar nga lista, mund të kontaktojnë direkt CRNVO-në për sqarimet e përjashtimit nga lista.

e) Çështjet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe OJQ-ve

Ky shërbim i referohet mundësisë së marrjes së të gjitha akteve që rregullojnë komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë dhe OJQ-ve (strategjitë, ligjet, rregulloret, vendimet etj.), duke përfshirë sqarimet e disa akteve.

Përdoruesi/ja këto informata mund ti marrë duke dërguar një e-mail në adresën crnvo@crnvo.me, ose duke telefonuar në numrin +382 20 219 121, brenda afatit kohor të specifikuar për shërbimet help-desk.

f) Çështjet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të vetëqeverisjeve lokale dhe OJQ-ve

Ky shërbim i referohet mundësisë së marrjes së të gjitha akteve që rregullojnë komunikimin dhe bashkëpunimin e qeverive lokale dhe OJQ-ve (strategjitë, vendimet etj.), duke përfshirë sqarimet e disa akteve.

Përdoruesi/ja këto informata mund ti marrë duke dërguar një e-mail në adresën crnvo@crnvo.me, ose duke telefonuar në numrin +382 20 219 121, brenda afatit kohor të specifikuar për shërbimet help-desk.

g) Ndërtimi i rrjetit dhe i partneriteteve në nivel shtetëror dhe atë lokal

Ky shërbim ka të bëjë me mundësinë e marrjes së informatave për organizatat e tjera joqeveritare në nivel shtetëror dhe lokal që punojnë në të njëjtat fusha të njëjta, me qëllim që të inkurajojë bashkëpunimin. Gjithashtu, ky shërbim duhet të ndihmojë OJQ-të në kërkimin e organizatave partnere me të cilat është e mundur të arrihet bashkëpunimi në bazë të projekteve, por edhe të krijohet bashkëpunim strategjik.

Përdoruesi/ja këto informata mund t'i marrë duke dërguar një e-mail në adresën crnvo@crnvo.me, ose duke telefonuar në numrin +382 20 219 121, brenda afatit kohor të specifikuar për shërbimet help-desk. Në mënyrë që të krijohet hapësirë për rrjetëzimin e OJQ -ve, si dhe për veprimin e tyre të përbashkët për çështje të rëndësishme me interes publik, do të organizohen ngjarje të veçanta, të cilat do të synojnë krijimin e rrjeteve joformale të OJQ-ve, si dhe ofrimin e mentorimit për këto rrjete.

h) Informata rreth donatorëve

Ky shërbim të ofron mundësinë për të marrë informata rreth donatorëve. Ky shërbim përfshin dhënien e informatave për donatorët aktualë të OJQ-ve në Mal të Zi, kontaktet e tyre dhe informatat mbi prioritetet, mënyrën e financimit, afatet, dorëzimin e formularit të aplikimit dhe të ngjashme.

Përdoruesi/ja këto informata mund ti marrë duke dërguar një e-mail në adresën crnvo@crnvo.me, ose duke telefonuar në numrin +382 20 219 121, brenda afatit kohor të specifikuar për shërbimet help-desk.

i) Mbështetje për OJQ-të në përgatitjen e iniciativave, komenteve dhe propozimeve në lidhje me politikat publike të cilat kanë të bëjnë me bashkëpunimin e OJQ-ve dhe organeve shtetërore, pjesëmarrjen e OJQ-ve në vendimmarrje, transparencën dhe llogaridhënien e nëpunësve civilë.

Për të mbështetur OJQ-të në nivel lokal dhe shtetëror në përgatitjen e iniciativave, komenteve dhe sugjerimeve që lidhen me politikat publike, si dhe inkurajimin e pjesëmarrjes më të madhe të OJQ-ve në procesin e vendimmarrjes, mbështetja e mentorëve sigurohet nga ekipi i qendrave të resurseve në nivel shtetëror dhe lokal. Mentorimi është një proces në të cilin qendrat e resurseve në nivel shtetëror dhe lokal ndjekin iniciativën e OJQ-ve që nga fillimi, përmes hartimit të draftit deri tek dorëzimi i saj dhe arritja e rezultatit përfundimtar, duke siguruar mbështetje në çdo hap.

2. Qendrat e Resurseve të lëvizshme

Në mënyrë që shërbimet e Qendrës së Resurseve në nivel shtetëror dhe atyre në nivelin lokal të jenë sa më të qasshme për numrin më të madh të OJQ-ve, do të organizohen aktivitetet "Ditët e Hapura të Qendrës së Resurseve". Këto ngjarje do të jenë një mundësi shtesë për të gjitha OJQ-të në të gjitha qytetet e Malit të Zi, në të cilët nuk ndodhen selitë e qendrave të resurseve, për të marrë shërbime dhe mbështetje të drejtpërdrejtë nga përfaqësuesit e konsorciumit të Qendrës së Resurseve.

3. Ofrimi i mentorimit të brendshëm

Përveç këtyre shërbimeve, OJQ-të "grassroot" (organizatat e sapo themeluara), OJQ-të e tjera dhe rrjetet e OJQ-ve do të mund të kërkojnë mbështetje nga përfaqësuesit e konsorciumit të Qendrës së Resurseve në formën e mentorimit të brendshëm. Mentorimi i brendshëm nënkupton mbështetje në përgatitjen e raporteve financiare, tenderëve, iniciativave ose në përgjithësi në realizimin e aktiviteteve të projektit, zgjidhjen e problemeve të caktuara, në funksionimin ose komunikimin me palët e interesuara. Ky shërbim do të ketë për qëllim veçanërisht ato organizata me bazë në komunat e vogla, të pazhvilluara, të cilat nuk kanë mjete financiare për të ardhur në QR dhe problemi i të cilave është i një natyre të tillë që kërkon disa orë konsultim.

4. Sigurimi i hapësirave falas dhe i mbështetjes PR për OJQ-të

Organizatave të shoqërisë civile iu ofrohet mbështetje në organizimin/përgatitjen e konferencave për media dhe ngjarjeve të ngjashme (trajnimeve, workshopeve, takimeve). Mbështetja nënkupton përdorimin falas të ambienteve të qendrave të resurseve në nivel shtetëror dhe lokal për organizimin e këtyre ngjarjeve, me kërkesë të OJQ-ve. Gjithashtu, OJQ-të mund të marrin mbështetje në përgatitjen e kumtesave publike dhe komunikimin me media.

5. Trajnime bazë dhe të avancuar për anëtarët e organizatave joqeveritare, mediave dhe organizatave mediatike

Përfaqësuesit e OJQ-ve, mediave dhe organizatave mediatike do të kenë mundësi të ndjekin programe të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve në kuadër të Qendrës së Resurseve.

Trajnimet realizohen në përputhje me mjetet në dispozicion, bazuar në nevojat e identifikuara përmes pyetësorit dhe kriterëve për përzgjedhjen e pjesëmarrësve. Trajnimet realizohen nga ekipi i trajnerëve të Qendrës së Resurseve.

Trajnimet/workshopet do të realizohen në fushat e mëposhtme:

- zhvillimi strategjik
- mobilizimi i qytetarëve – mobilizimi i komunitetit
- hartimi i projekteve dhe mënyra alternative për sigurimin e fondeve
- komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun
- me fakte drejt Bashkimit Evropian – hartimi i dokumenteve politike dhe avokimi
- planifikimi strategjik afatgjatë i organizatës
- monitorimi dhe vlerësimi
- hartimi i projekteve për fondet e BE-së
- hartimi i propozimit të projekteve për fondet vendore
- zhvillimi i planit për menaxhimin e burimeve njerëzore
- workshope në temën e bazave të gazetarinë për studentët dhe gazetarët e rinj
- workshope mbi verifikimin e fakteve për media dhe organizata mediatike.



CRNVO
CENTAR ZA RAZVOJ NVO



RESURSNICENTAR
Centar za razvoj nevladinih organizacija



Ky dokument u krijua në kuadër të projektit Qendra e Resurseve për Organizatat e Shoqërisë Civile – Faza II, të cilin e realizon Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare - CRNVO, në partneritet me Institutin për Media të Malit të Zi dhe OJQ Natura, financiar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e CRNVO dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Mënyra e komunikmit

Subjektet e interesuara të cilët zgjedhin korrespondencën me e-mail dhe përfitimin e shërbimeve në këtë mënyrë, duhet të kontaktojnë adresat e e-mailit të qendrave të resurseve në nivel shtetëror dhe lokal duke përdorur formularin në vazhdim të tekstit.

Për të mbuluar sa më shumë territorin e Malit të Zi, qendrat e resurseve në nivel shtetëror dhe lokal do të ofrojnë shërbime për OJQ-të nga komunat e renditura si më poshtë:

CRNVO (Podgoricë, Nikshiq, Cetinë, Danillovgrad):

e-mail: crnvo@crnvo.me

tel: +382 20 219 121, 219 120

Natura (Kollashin, Mojkovac, Rozhajë, Plavë, Guci)

e-mail: natura@t-com.me

tel: 069/074-766

Bonum (Plevle, Zhablak, Shavnik):

e-mail: bonum@t-com.me

tel/fax +382 52 321 732

Qendra Demokratike e Bijello Poles (Bijelo Polje, Petnjica, Berane, Andrijevicë):

e-mail: nvobdcbp@gmail.com

tel/fax: +382 68 571 321;

Mob: +382 69 256 213

OJQ Nada (Herceg Novi, Kotor, Tivat):

e-mail: nvonada@t-com.me; gkhn@t-com.me

tel/fax: +382 31 321 444;

Mob: 069 755 095;

Horizonti i RI (Ulqin, Tivar, Budva):

e-mail: horizon@t-com.me

tel: +382 68 300 603

Mënyra e kthimit të përgjigjeve

Qendrat e resurseve në nivel shtetëror dhe lokal kanë detyrim që në një kërkesë për shërbim në formë elektronike, të përgjigjen brenda 72 orëve dhe të ofrojnë udhëzime të mëtejshme lidhur me ofrimin e shërbimit.

Formulari për shfytëzuesit e shërbimeve

Emri dhe mbiemri / Emri i organizatës	
Telefoni kontaktues	
E-maili	
Lloji i shërbimit (shënoni me X në kolonën në të djathtë)	
Mbështetje në themelimin e OJQ-ve	
Konsulencë ligjore dhe financiare për punën e OJQ-ve	
Konsultimet në përgatitjen e projektit dhe implementimin e projektit (konkurse në nivel vendorë dhe shtetëror për projekt propozime, projekte të financuara nga fondet e BE-së, konkurse tek donatorë të tjerë)	
Informata ditore në lidhje me të gjitha thirrjet publike për OJQ-të, ngjarjet, lajmet në lidhje me OJQ-të nëpërmjet listës elektronike të CRNVO-së	
Çështjet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe OJQ-ve	
Çështjet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të vetëqeverisjeve lokale dhe OJQ-ve	
Ndërtimi i rrjeteve dhe partneriteteve në nivel shtetëror dhe lokal	
Informata për palët e interesuara në lidhje me politikat shtetërore në fusha të caktuara	
Informata rreth donatorëve	
Mbështetje në komunikim me publikun	
Mbështetje e OJQ-ve në përgatitjen e iniciativave, komenteve dhe sugjerimeve në lidhje me politikat publike	

Regjistrimi i ofrimit të shërbimeve

CRNVO dhe qendrat e resurseve lokale mbajnë regjistrimet e shërbimeve të ofruara gjatë vitit. Të dhënat për shërbimet e ofruara janë pjesë përbërëse e raportit vjetor për punën e qendrave të resurseve në nivel shtetëror dhe lokal.

Pyetësori individual

Emri dhe mbiemri / Emri i organizatës	
Adresa	
Telefoni kontaktues	
E-maili	
Lloji i shërbimit (përshkrim i detajuar)	
Rezultati përfundimtar i konsultimit / Komenti	
Konsultimet i ofroi:	
Lloji i konsultimit (takim, thirrje telefonike, e-mail)	
Data dhe orari	

PYETËSOR PËR SHFRYTËZUESIT E QENDRËS SË RESURSEVE PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Ky pyetësor është hartuar me qëllim që të vlerësojë nivelin e kënaqësisë së shfrytëzuesve të Qendrës së Resurseve për organizatat joqeveritare (në vijim: QR) në lidhje me cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Vlerësimet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja do të na ndihmojnë të përmirësojmë punën tonë për të mirën reciproke.

Ju lutemi, dërgoni pyetësorin e plotësuar në: crnvo@crnvo.me

Pyetësorin mund ta plotësoni në mënyrë elektronike duke përdorur linkun:

<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSddgO5SHHK9VyX6J1WmfGY9NNGUO1yZxdFvgTzLGYGKzF8rxw/viewform>

Ju falënderojmë paraprakisht për kontributin tuaj.

1. HELP-DESK

a) Mbështetje për themelimin e OJQ-ve

Si i vlerësoni këshillat dhe përkrahjen e QR në krijimin e OJQ-së tuaj? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëni për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

b) Konsulencë ligjore dhe financiare për punën e OJQ-ve

Si e vlerësoni konsulencën ligjore dhe financiare të QR të nevojshme për funksionimin e OJQ-së tuaj? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Ju lutem përshkruani.

c) Konsultimet në përgatitjen e projektit dhe implementimin e projektit (konkurse në nivel vendorë dhe shtetëror për projekt propozime, projekte të financuara nga fondet e BE-së, konkurse tek donatorë të tjerë)

Si e vlerësoni këshillën e QR në përgatitjen e projekteve që OJQ-ja juaj konkurron tek donatorët vendas dhe ndërkombëtarë? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

Si i vlerësoni këshillat e QR në zbatimin e projektit të OJQ-së tuaj? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

d) Informata ditore në lidhje me të gjitha thirrjet publike për OJQ-të, ngjarjet, lajmet në lidhje me OJQ-të nëpërmjet listës elektronike të CRNVO-së

Si e vlerësoni cilësinë e informacionit në lidhje me thirrjet publike, ngjarjet, lajmet në lidhje me OJQ-të, të cilat shpërndahen përmes listës së CRNVO? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

e) Çështjet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe OJQ-ve

Si e vlerësoni cilësinë e informacionit që keni marrë nga QR lidhur me aktet që rregullojnë komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë dhe OJQ-ve (strategjitë, ligjet, urdhëresat, vendime, etj.), duke përfshirë sqarimet e akteve specifike? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

f) Çështjet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të vetëqeverisjeve lokale dhe OJQ-ve

Si e vlerësoni cilësinë e informacionit që keni marrë nga QR në lidhje me aktet që rregullojnë komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet qeverive vendore dhe OJQ-ve (strategjitë, vendimet, etj.), duke përfshirë sqarime të akteve specifike? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

g) Ndërtimi i rrjeteve dhe partneriteteve në nivel shtetëror dhe lokal

Si e vlerësoni cilësinë e informacionit që keni marrë nga QR në lidhje me organizatat e tjera joqeveritare në nivel shtetëror dhe lokal, të cilat punojnë në të njëjtat fusha si OJQ-ja juaj, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit, krijimit të një partneriteti ose bashkëpunimi strategjik? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

h) Informacion rreth donatorëve

Si e vlerësoni cilësinë e informacionit që keni marrë nga QR lidhur me donatorët aktualë për OJQ-të në Malin e Zi, të dhënat dhe informatat mbi prioritetet, mënyrën e financimit, afatet, dorëzimin e formularit të aplikimit etj? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

1. Mbështetje në komunikimin me publikun

Si e vlerësoni cilësinë e mbështetjes që keni marrë nga QR në lidhje me organizimin/përgatitjen e konferencave për media dhe ngjarjeve të ngjashme (trajnimeve, workshopeve, takimeve) në ambientet e QR, si dhe mbështetjes në përgatitjen e njoftimeve për shtyp dhe komunikimit me media? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

2. Mentorimi për OJQ-të në përgatitjen e iniciativave, komenteve dhe sugjerimeve mbi politikat publike

Si e vlerësoni cilësinë e mbështetjes së mentorimit që keni marrë nga QR në lidhje me iniciativën e OJQ-së tuaj (hartimin e iniciativës, deri në dorëzimin dhe arritjen e rezultatit përfundimtar? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

3. Trajnim bazë dhe i avancuar për anëtarët e organizatave joqeveritare

Vërejtje: vlerësimi i cilësisë së trajnimit të realizuar për organizatat joqeveritare do të kryhet menjëherë pas përfundimit të trajnimit.

4. Mënyra e komunikimit

Si e vlerësoni mënyrën e komunikimit me QR në lidhje me ofrimin e shërbimeve (duke u përgjigjur brenda 72 orëve pas pranimit të kërkesës në formë elektronike dhe komunikimit të udhëzimeve të mëtejshme lidhur me ofrimin e shërbimit)? (nota më e ulët -1, nota maksimale -5, shëno me X)

1	2	3	4	5

Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi të QR? Të lutem, përshkruaj.

5. Sugjerime shtesë

Nëse ka sugjerime të tjera për përmirësimin e performancës së QR, ju lutem përshkruani.



CRNVO
CENTAR ZA RAZVOJ NVO



RESURSNI CENTAR
Centar za razvoj nevladinih organizacija



Institut za medije Crne Gore
Montenegro Media Institute



NVO Natura-Kolašin



